



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe nenit 18.1 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2014, miratoi,

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Miratohet kërkesa e Muharrem Isufit nga fshati Majac, Komuna e Podujevës, për ndërrimin e përherëshëm të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 622-1 kultura – arë, kl, 3, vendi i quajtur ara nën rrugë, në sipërfaqe prej 10,00 ari (1000m²), Zona kadastrave Majac, Certifikata nr. 08/095/60683/2014.

Neni 2

Pronari obligohen që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzoj për ndërtimin e objektit për fermë të kafshëve.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-320-64163
Podujevë,
31 korrik 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi